



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

NJOFTIM PËR VEND PUNE

**SHPLLJE PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA PËR KATEGORINË E ULËT
DREJTUESE**

Për të dyja procedurat (lëvizje paralele/ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Pozicioni i mësipërm u ofrohet nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se këto pozicione janë ende vakant, ato janë të vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

I. LËVIZJE PARALELE BRENDIA SË NJËJTËS KATEGORI

Shpallje për lëvizjen paralele brenda së njëjtës kategori për plotësimin e vëndit të lirë të punës në AKEP.

1. Në zbatim të Kreut V të Ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe Kreut II, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) shpall procedurat e lëvizjes paralele brenda së njëjtës kategori, për pozicionin:

Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të

Monitorimit të SFR

Drejtorinë e Monitorimeve, Kontrollit dhe Inspektimeve

Kategoria e pagës III-a

2. Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:

- MISIONI :

Siguron zbatimin me profesionalizëm dhe përgjegjësi të detyrave funksionale të njësisë organizative lidhur me administrimin e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të SRF dhe përpunimin e të dhënave të monitorimit fiks dhe të lëvizshëm, për të garantuar përdorimin e spektrit të frekuencave në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave, Planin e Përdorimit të Frekuencave dhe kushtet e përcaktuara në autorizimet individuale për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave; administrimin e programit të monitorimit të cilësisë së rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike për garantimin e standardeve teknike dhe të cilësisë së ofrimit nga sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të autorizuar.

- QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS:

Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit të SFR përgjigjet përpara Drejtorit të Drejtorisë së Monitorimeve, Kontrollit dhe Inspektimeve për zbatimin me profesionalizëm dhe përgjegjësi të detyrave funksionale të njësisë organizative lidhur me administrimin e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të SRF dhe përpunimin e të dhënave të monitorimit fiks dhe të lëvizshëm, për të garantuar përdorimin e spektrit të frekuencave në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave, Planin e Përdorimit të Frekuencave dhe kushtet e përcaktuara në autorizimet individuale për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave, garantimin e standardeve teknike dhe të cilësisë së ofrimit nga sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të autorizuar, me qëllim përmbushjen e misionit të drejtorisë, objektivave si dhe detyrimeve ligjore dhe rregullatore.

- DETYRAT KRYESORE

Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit të SFR, siguron që:

1. Drejtimi, organizimi dhe koordimi i punës midis specialistëve në përbërje të sektorit që drejon, të garantojë kryerjen në afat, profesionalizëm dhe përgjegjshmëri të detyrave funksionale, si dhe çdo detyre tjetër të ngarkuar nga eprori direkt në kuadër të fushveprimit të njësisë organizative.
2. Drejtorit të drejtorisë ti jepen hollësi mbi administrimin dhe mbarëvajtjen e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të SRF dhe përpunimit të të dhënave të monitorimit fiks dhe të lëvizshëm, për të garantuar përdorimin e spektrit të frekuencave në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave, Planin e Përdorimit të Frekuencave dhe kushtet e përcaktuara në autorizimet individuale për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave.
3. Ti japi hollesi Drejtorit të drejtorisë për kryerjen e detyrave operacionale dhe administrimin e programit të monitorimit të cilësisë së rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve

elektronike me qëllim garantimin e standardeve teknike dhe të cilësisë së ofrimit nga sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të autorizuara.

4. Ti japi hollësi drejtorit të drejtorisë për rezultatet dhe rekomandimet mbi masat përkatëse që duhen marrë sipas përfundimeve të raporteve periodike dhe të planifikuara të monitorimit të spektrit të frekuencave dhe monitorimit të cilësisë (QoS) të ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.
5. Raportimi dhe dhënia e informacionit periodik dhe të vazhdueshëm për punën dhe përmbushjen e detyrave të sektorit në kuadër të veprimtarisë së njësisë organizative, të kryhet në afat dhe sipas procedurës së përcaktuar në aktet e nxjerra nga Titullari për këtë qëllim.
6. Të kryhen analizat e nevojshme të rriskut dhe ti jepen hollësitë e nevojshme Drejtorit të Drejtorisë për gjendjen e përdorimit të spektrit të frekuencave dhe zbatimin e parametrave dhe standardeve të miratuara të cilësisë së ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike nga sipërmarrësit e autorizuar, si dhe që të bëhen parashikimet e pritshme të realizimit të këtyre treguesve.
7. Udheheq, mbykqyr dhe siguron mbarevajtjen e detyrave funksionale të sektorit të Administrimit të Qendres Kombetare të Monitorimit të Frekuencave dhe zyrave Rajonale për proceset e monitorimit të përdorimit të spektrit të frekuencave dhe interferencave ;
8. Merr pjesë në matjet dhe testet e nevojshme me qëllim që të sigurojë që spektri i radiofrekuencave përdoret vetëm nga përdoruesit e ligjshëm dhe në përputhje me rregullat e caktuara nga AKEP;
9. Mbykqyr për gatitjen e raporteve të detajuara mbi të dhënat e matjeve të kryera duke përfshirë të dhënat e Okupimit të Kanaleve të Frekuencave (FCO), Okupimit të Brezave të Frekuencave (FBO);
10. Mbykqyr procesin e mbledhjes së të dhënave të vlefshme të monitorimit për procesin e menaxhimit të spektrit të frekuencave lidhur me përdorimin aktual të frekuencave dhe brezave (p.sh., zënia e kanaleve dhe brezave), verifikimin e karakteristikave teknike dhe operacionale të sinjaleve të transmetuara, detektimin dhe identifikimin e transmetuesve ilegalë, dhe gjenerimi dhe verifikimi i regjistrimit të frekuencave;
11. Mbykqyr grupet e punës të cilat kryejnë kontrollin e treguesve të cilësisë së shërbimit për aksesin në rrjetat GSM/ UMTS/LTE etj dhe merr pjesë në matjet dhe testet e nevojshme.
12. Mbykqyr procesin e depozitimit të treguesve të cilësisë së shërbimit sipas periudhave periodike të përcaktuara në rregulloret si dhe verifikimin i sakteësisë dhe vërtetësisë së këtyre treguesve.

13. Mbikëqyr mbledhjen dhe perpunimin e informacioneve të vlefshme të monitorimit për programet e organizuar nga Byroja e Radiokomunikacioneve të ITU, p.sh. në përgatitjen e raporteve të Konferencave të Radiokomunikacioneve,
14. Merr pjese dhe jep asistencë teknike, në grupet e matjeve, kur kërkohej nga institucionet e shtetit;
15. Ndjek zhvillimet teknologjike të fushës së tij dhe bëjë propozime për përmirësimet teknologjike të sistemit të monitorimit;
16. Bashkepunon me sektorin e Administrimit dhe Koordinimit të SRF mbi identifikimin e operatoreve interferues dhe Sektorit të Kontrollit dhe Inspektimit
17. Bashkepunon me sektorin e Autorizimeve me qëllim verifikimin e zbatimit të kushteve të autorizimeve lidhur me përdorimin e spektrit;
18. Përgatit dhe paraqet pranë Drejtorit të Drejtorisë planë mujore dhe tremujore të Sektorit;
19. Harton raportet e punës për sektorin dhe t'ia paraqesë Drejtorit të Drejtorisë;
20. Udhëheq dhe drejton veprimtarinë e sektorit si dhe është përgjegjës për mbarevajtjen e punës së specialistëve në varesi;
21. Propozon kualifikimet e nevojshme për punonjësit e sektorit në bashkëpunim me specialistët.

3. Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë :

Arsimi : Të zotërojë diplomë “Master Shkencor” në Shkencat e Inxhinierisë Elektronike, Shkencat e Telekomunikacionit/ Shkencat e Teknologjisë Informacioni/Shkencat Inxhinierisë Informatike.

Përvoja : Të ketë eksperiencë profesionale në fushën e komunikimeve elektronike, telekomunikacionit, juridike, administrative, sisteme GIS dhe monitorimit, administrimit të frekuencave.

Të tjera : Të detyrueshme,

- Njohuri të mira lidhur me fushën e administrimit dhe monitorimit të spektrit të frekuencave, standardeve ndërkombëtare mbi cilësinë e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, përgjegjësisë së institucionit në këto drejtime, dhe aftësi të mira drejtimi (leadership), aftësi analitike, komunikimi, negocimi ;
- Kërkohej rregullisht gjykim dhe iniciativë për t'u marrë me probleme konstante dhe operacionale ;

- Të ketë trajnime në lidhje me praktikat rregullatore monitoruese të SRF dhe QoS;
- Njohuri shumë të mira praktike në përdorimin e kompjuterit dhe të programeve aplikative të monitorimit dhe administrimit të frekuencave dhe aftësi për të përpunuar të dhëna teknike;
- Njohja e gjuhës angleze e çertifikuar në nivel profesional. Çdo gjuhë e huaj tjetër përbën avantazh.

4. **Kushtet minimale** që duhet të plotësojnë kandidatët për këtë procedure, janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë, të paktën, vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;
- ç- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posacme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

5. **Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Protokollit të AKEP, dokumentet e dosjes së tij personale:**

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Jetëshkrimi CV (mund të hartohet në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun [http://dap.gov.al/vende -vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta](http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta))
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID) ose Pashaportës.
- Fotokopje të diplomave.
- Fotokopje të listës se notave.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vertetojnë eksperiencën në punë).
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
- Aktin e emërimit si nëpunës civil.
- Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi
- Vërtetimin e gjendjes shëndetësore.
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- Formulari i vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike sipas linkut <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/104-formularin-i-vetedeklarimit-per-garantimin-e-integritetit-te-personave-qe-zgjidhen-emerohen-ose-ushtrone-funksione-publike->

6. Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në zyrën e Protokollit, të Autoritetit i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Rr. Reshit Çollaku, brenda datës **11.11.2019**.

7. **Rezultatet për verifikimin paraprak** të kushteve minimale të procedurës lëvizje paralele brënda së njejtës kategori dhe të përmbushjes së kriterëve specifike të vendit të punës do të dalin në datë **13.11.2019** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të AKEP. Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 3 ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve pune nga data e depozitimit të saj.
8. **Konkurimi -Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **25.11.2019** ora **11:00**.

9. **Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Punes
- Kodi i Procedurave Administrative
- Kodi Civil
- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe akteve nënligjore të tij;
- Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”
- Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar
- Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 ”Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” i ndryshuar
- Ligjin nr. 9918, datë 19.08.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, (<http://www.akep.al/legjislacioni/ligje>)
- Ligjin Nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” (<http://www.akep.al/legjislacioni/ligje>)
- RREGULLORE
<https://akep.al/legjislacioni/rregullore>
<https://akep.al/sherbim-postar/rregullore>
- <http://www.akep.al/legjislacioni> (Ligj, VKM, Rregullore, në faqen zyrtare të AKEP)

10. **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:**

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komiteti i Pranimit për Levizje Paralele (KPLP) i ngritur në AKEP**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnime dhe kualifikime në fushën përkatëse, si dhe 10 pike për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.
- b. **60 pikë** për intervistën e strukturuar me gojë.

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit të SFR.**

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 23, Kreu II të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar.

11. Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të njoftohet në datën **25.11.2019.**

12. **Njoftimi do të bëhet:** në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **06.12.2019.**

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civil të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

Vetëm në rast se pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë se janë ende vakante, ato janë të vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë .

II. NGRITJE NË DETYRË

1. Shpallje për ngritje në detyrë/pranim nga jasht shërbimit civil për plotësimin e vëndit të lirë të punës në AKEP:

Në zbatim të Kreut V të Ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe Kreut III të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”i ndryshuar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) shpall procedurat e Ngritjes në Detyrë:

Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit të SFR

Drejtorinë e Monitorimeve, Kontrollit dhe Inspektimeve

Kategoria e pagës III-a

2. Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:

- MISIONI :

Siguron zbatimin me profesionalizëm dhe përgjegjësi të detyrave funksionale të njësisë organizative lidhur me administrimin e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të SRF dhe përpunimin e të dhënave të monitorimit fiks dhe të lëvizshëm, për të garantuar përdorimin e spektrit të frekuencave në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave, Planin e Përdorimit të Frekuencave dhe kushtet e përcaktuara në autorizimet individuale për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave; administrimin e programit të monitorimit të cilësisë së rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike për garantimin e standardeve teknike dhe të cilësisë së ofrimit nga sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të autorizuar.

- QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS:

Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit të SFR përgjigjet përpara Drejtorit të Drejtorisë së Monitorimeve, Kontrollit dhe Inspektimeve për zbatimin me profesionalizëm dhe përgjegjësi të detyrave funksionale të njësisë organizative lidhur me administrimin e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të SRF dhe përpunimin e të dhënave të monitorimit fiks dhe të lëvizshëm, për të garantuar përdorimin e spektrit të frekuencave në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave, Planin e Përdorimit të Frekuencave dhe kushtet e përcaktuara në autorizimet individuale për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave, garantimin e standardeve teknike dhe të cilësisë së ofrimit nga sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të autorizuar, me qëllim përmbushjen e misionit të drejtorisë, objektivave si dhe detyrimeve ligjore dhe rregullatore.

- DETYRAT KRYESORE:

Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit të SFR, siguron që:

- 1) Drejtimi, organizimi dhe koordimi i punës midis specialistëve në përbërje të sektorit që drejton, të garantojë kryerjen në afat, profesionalizëm dhe përgjegjshmëri të detyrave funksionale, si dhe çdo detyre tjetër të ngarkuar nga eprori direkt në kuadër të fushveprimit të njësisë organizative.
- 2) Drejtorit të drejtorisë ti jepen hollësi mbi administrimin dhe mbarëvajtjen e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të SRF dhe përpunimit të të dhënave të monitorimit fiks dhe të lëvizshëm, për të garantuar përdorimin e spektrit të frekuencave në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave, Planin e Përdorimit të Frekuencave dhe kushtet e përcaktuara në autorizimet individuale për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave.

- 3) Ti japi hollësi Drejtorit të drejtorisë për kryerjen e detyrave operacionale dhe administrimin e programit të monitorimit të cilësisë së rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike me qëllim garantimin e standardeve teknike dhe të cilësisë së ofrimit nga sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të autorizuara.
- 4) Ti japi hollësi Drejtorit të drejtorisë për rezultatet dhe rekomandimet mbi masat përkatëse që duhen marrë sipas përfundimeve të raporteve periodike dhe të planifikuara të monitorimit të spektrit të frekuencave dhe monitorimit të cilësisë (QoS) të ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.
- 5) Raportimi dhe dhënia e informacionit periodik dhe të vazhdueshëm për punën dhe përmbushjen e detyrave të sektorit në kuadër të veprimtarisë së njësisë organizative, të kryhet në afat dhe sipas procedurës së përcaktuar në aktet e nxjerra nga Titullari për këtë qëllim.
- 6) Të kryhen analizat e nevojshme të rriskut dhe ti jepen hollësitë e nevojshme Drejtorit të Drejtorise për gjendjen e përdorimit të spektrit të frekuencave dhe zbatimin e parametrave dhe standardeve të miratuara të cilësisë së ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike nga sipërmarrësit e autorizuar, si dhe që të bëhen parashikimet e pritshme të realizimit të këtyre treguesve.
- 7) Udhëheq, mbikëqyr dhe siguron mbarëvajtjen e detyrave funksionale të sektorit të Administrimit të Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave dhe zyrave Rajonale për proceset e monitorimit e përdorimit të spektrit të frekuencave dhe interferencave.
- 8) Merr pjesë në matjet dhe testet e nevojshme me qëllim që të sigurojë që spektri i radiofrekuencave përdoret vetëm nga përdoruesit e ligjshëm dhe në përputhje me rregullat e caktuara nga AKEP.
- 9) Mbikëqyr përgatitjen e raporteve të detajuara mbi të dhënat e matjeve të kryera duke përfshirë të dhëna të Okupimit të Kanaleve të Frekuencave (FCO), Okupimit të Brezave të Frekuencave (FBO);
- 10) Mbikëqyr procesin e mbledhjes së të dhënave të vlefshme të monitorimit për procesin e menaxhimit të spektrit të frekuencave lidhur me përdorimin aktual të frekuencave dhe brezave (p.sh., zënia e kanaleve dhe brezave), verifikimin e karakteristikave teknike dhe operacionale të sinjaleve të transmetuara, detektimin dhe identifikimin e transmetuesve ilegalë, dhe gjenerimi dhe verifikimi i regjistrimit të frekuencave.
- 11) Mbikëqyr grupet e punës të cilat kryejnë kontrollin e treguesve të cilësisë së shërbimit për aksesin në rrjetat GSM/ UMTS/LTE etj dhe merr pjesë në matjet dhe testet e nevojshme.
- 12) Mbikëqyr procesin e depozitimit të treguesve të cilësisë së shërbimit sipas periudhave periodike të përcaktuara në rregullorë si dhe verifikimin i saktësisë dhe vërtetësisë së këtyre treguesve.

- 13) Mbikëqyr mbledhjen dhe përpunimin e informacioneve të vlefshme të monitorimit për programet e organizuar nga Byroja e Radiokomunikacioneve të ITU, p.sh. në përgatitjen e raporteve të Konferencave të Radiokomunikacioneve,
- 14) Merr pjesë dhe jep asistencë teknike, në grupet e matjeve, kur kërkohet nga institucionet e shtetit;
- 15) Ndjek zhvillimet teknologjike të fushës së tij dhe bën propozime për përmirësimet teknologjike të sistemit të monitorimit;
- 16) Bashkëpunon me sektorin e Administrimit dhe Koordinimit të SRF mbi identifikimin e operatorëve interferues dhe Sektorin e Kontrollit dhe Inspektimit
- 17) Bashkëpunon me sektorin e Autorizimeve me qëllim verifikimin e zbatimit të kushteve të autorizimeve lidhur me përdorimin e spektrit;
- 18) Përgatit dhe paraqet pranë Drejtorit të Drejtorisë planet mujore dhe tremujore të Sektorit;
- 19) Harton raportet e punës për sektorin dhe t’ia paraqesë Drejtorit të Drejtorisë;
- 20) Udhëheq dhe drejton veprimtarinë e sektorit si dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së specialistëve në varësi;
- 21) Propozon kualifikimet e nevojshme për punonjësit e sektorit në bashkëpunim me specialistët.

3. Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë :

Arsimi : Të zotëroje diplomë “Master Shkencor” në Shkencat e Inxhinierise Elektronike, Shkencat e Telekomunikacionit/ Shkencat e Teknologjisë Informacioni/Shkencat Inxhinierisë Informatike.

Përvoja : Të ketë eksperiencë profesionale në fushën e komunikimeve elektronike, telekomunikacionit, juridike, administrative, sisteme GIS dhe monitorimit, administrimit të frekuencave.

Të tjera : Të detyrueshme,

- Njohuri të mira lidhur me fushën e administrimit dhe monitorimit të spektrit të frekuencave, standardeve ndërkombëtare mbi cilësinë e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, përgjegjësisë së institucionit në këto

drejtime, dhe aftësi të mira drejtimi (leadership), aftësi analitike, komunikimi, negocimi ;

- Kërkohej rregullisht gjykim dhe iniciativë për t'u marrë me probleme konstante dhe operacionale ;
- Të ketë trajnime në lidhje me praktikën rregullatore monitoruese të SRF dhe QoS;
- Njohuri shumë të mira praktike në përdorimin e kompjuterit dhe të programeve aplikative të monitorimit dhe administrimit të frekuencave dhe aftësi për të përpunuar të dhëna teknike;
- Njohja e gjuhës angleze e certifikuar në nivel profesional. Çdo gjuhë e huaj tjetër përbën avantazh.

4. Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët, për këtë procedurë, janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;
- ç- Të plotësojë kushtet e tjera të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, për klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil;
- d- Të përmbushë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

5. Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Protokollit të AKEP, dokumentet e dosjes së tij personale:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: [http://dap.gov.al/vende -vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta](http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta).
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID) ose Pashaportës.
- Fotokopje të diplomave.
- Fotokopje të listës së notave.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vertetojnë eksperiencën në punë).
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
- Aktin e emërimit si nëpunës civil.
- Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi
- Vërtetimin e gjendjes shëndetësore.
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- Formulari i vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike sipas linkut <http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/104-formularin-i-vetedeklarimit->

6. Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në zyrën e Protokollit, të Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Rr. Reshit Çollaku, brenda datës **16.11.2019**.

7. **Rezultatet për verifikimin paraprak** të kandidateve që përmbushin kushtet dhe kërkesat e vecanta, të përcaktuara në shpalljen në konkurim do të dalin në datë **26.11.2019** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të AKEP. Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 5 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

8. **Konkurimi**

- **Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **11.12.2019** ora **11:00**.

- **Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **11.12.2019** ora **13:00**.

9. **Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Punes
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Punes
- Kodi i Procedurave Administrative
- Kodi Civil
- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”i ndryshuar dhe akteve nënligjore të tij;
- Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Ligjin 119/2014 “Për të drejten e informimit”
- Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar

- Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë" i ndryshuar
- Ligjin nr. 9918, datë 19.08.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, (<http://ëëë.akep.al/legjislacioni/ligje>)
- Ligjin Nr. 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë" (<http://www.akep.al/legjislacioni/ligje>)
- RREGULLORE
<https://akep.al/legjislacioni/rregullore>
<https://akep.al/sherbim-postar/rregullore>
- <http://www.akep.al/legjislacioni> (Ligj, VKM, Rregullore, në faqen zyrtare të AKEP).

10. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë në AKEP**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **20** pikë për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. **40** pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. **40** pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit të SFR**.

Kandidati fitues, është ai që renditet i pari nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70 % të pikëve). Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikes 23, Kreu II të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese" i ndryshuar.

11. Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të njoftohet në datën **11.12.2019**.

12. **Njoftimi do të bëhet:** në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **23.12.2019**.